



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.194/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi - kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Partia Socialdemokrate (PSD) më seli në Komuna Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET E BAZUAR ankesa e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, ZL.Anr.194/2025 datë 11.10.2025.

II. Subjektit Politik Partia Socialdemokrate (PSD) për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 të datës 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 1,000.00 Euro (njëmijë Euro).

III. Detyrohet Subjekti Politik Partia Socialdemokrate (PSD) që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 11.10.2025 në PZAP, është parashtruar ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se kandidati Qëndron Kastrati për kryetar të Komunës së Kamenicës nga subjekti politik Partia Socialdemokrate (PSD), gjatë fushatës zgjedhore të dt. 11.10.2025, në profilin e tij në Facebook, ka bërë një publikim më përmbajtje të qartë elektorale, të realizuar gjatë një vizite në Brigadën e Zjarrfikësve të Kamenicës. Tutje parashtruesi i ankesës thekson se në përmbajtje të postimit të lartcekur, kandidati Qëndron Kastrati ka dhënë premtime për ndërtimin e një objekti të ri për stacionin e zjarrfikësve në Kamenicë si dhe sigurimin shëndëtsor të zjarrfikësve dhe se i njëjti kandidat sipas

parashtruesit të ankesës ka shkelur dispozitat e nenit 36 paragrafi 1, i LZP-së duke përdorur resurset shtetërore të nivelit lokal për qëllim të fitimit të votave. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartëcekura, ankuesi kërkon që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si prova, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur : Postimin publik të kandidatit Qëndron Kastrati në rrjetin social Facebook dhe fotografitë të bashkangjitura brenda ambientit të Brigadës së Zjarrfikësve në Kamenicë.

Në përgjigje në ankesë të subjektit politik Partia Socialdemokrate (PSD) theksojnë se baza ligjore në të cilën është thirrur subjekti politik LVV nuk është e zbatueshme në rastin konkret për shkak se dispozitat e përmendura në ankesë kanë të bëjnë me kufizimet që u vendosen nëpunësve publikë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, ndërkohë që kandidati i PSD-së , Qëndron Kastrati nuk ka cilësinë e nëpunësit publik duke sqaruar termin “nëpunës publik” bazuar në nenin 1.35 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme. Tutje, theksojnë se kandidati Qëndron Kastrati nuk ushtron asnjë funksion publik, nuk është në marrëdhënie punë me ndonjë institucion publik dhe nuk ka kompetenca administrative apo ekzekutive, ndaj nuk mund të trajtohet si subjekt ndaj të cilit gjen zbatim neni 36 i LZP dhe neni 6 i Rregullores për Fushatën Zgjedhore. PSD shtojnë së në përputhje me parimet e garantuara të fushatës zgjedhore, çdo kandidat ka të drejtë të zhvilloj aktivitete programore, dhe komunikim publik në hapësira që lidhen me interesin e qytetarëve përfshirë dhe vizitat në institucione që ofrojnë shërbime publike. Sipas tyre, kjo është pjesë përbërëse e një fushatë normale dhe demokratike, përmes se cilës kandidatët njihen me realitetin e terrenit dhe prezantojnë qëndrimet e tyre për përmirësimin e shërbimeve publike. Në rastin konkret, përmbajtja e postimit të bërë nga kandidati Qëndron Kastrati, takimi me zjarrfikësit ka pasur karakter programor ku kandidati ka folur për nevojat reale të komunës dhe përkushtimin e tij për t'i adresuar në të ardhmen, duke theksuar ndërtimin e një objekti të ri për Stacionin e Zjarrfikësve në Kamenicë. Këto vizita janë pjesë integrale e fushatës programore, nëpërmjet se cilës kandidatët prezantojnë vizionin e tyre për qeverisjen lokale dhe përmirësimin e shërbimeve publike dhe se kjo vizitë përfaqëson veprim të zakonshëm dhe të lejueshëm gjatë fushatës, që bie brenda praktikave zgjedhore. Kjo lloj vizitë nuk implikon mbështetje institucionale ndaj kandidatit dhe as nuk krijon perceptim të tillë, për aq kohë sa është e hapur, transparente dhe nuk shoqërohet me përdorim të resurseve të institucionit për fushatë. Andaj, duke u mbështetur në këto argumente, PSD propozon PZAP-in që të konstatojë se ankesa e paraqitur nga subjekti politik LVV është e pabazuar në ligj dhe si e tillë të refuzohet në tërësi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale të bashkangjitura ankesës, të Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe shkresave tjera të lëndës, është vërtetuar se Qëndron Kastrati, kandidat për kryetar të Komunës së Kamenicës nga subjekti politik Partia Socialdemokrate (PSD), ka shfrytëzuar pozitën si kandidat për

kryetar të komunës me qëllim të përfitimit të votave në fjalimin e mbajtur në Brigadën e Zjarrfikësve të Kamenicës çka përbën përdorim të resurseve publike, dhe Institucioneve Komunale për qëllime të fushatës.

Bazuar në këtë kandidati nga Subjekti Politik Partia Socialdemokrate (PSD) Qëndron Kastrati ka shkelur dispozitën e nenit 36 paragrafi 3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik”*.

Sipas vlerësimit të panelit, duke u bazuar edhe në provat materiale, konstatohet se kandidati nga subjekti politik PSD Qëndron Kastrati ka zhvilluar takim brenda ambientit të Brigadës së Zjarrfikësve të Kamenicës gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e Qëndron Kastratit, kandidati për kryetar të Komunës së Kamenicës nga subjekti politik Partia Socialdemokrate (PSD), bien ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 3 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që i njëjti me takimin e mbajtur me zjarrfikësit e komunës së Kamenicës gjatë fushatës zgjedhore ka pasur qëllim të vetëm përfitimin e votave në zgjedhjet lokale të 12 tetor 2025.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.194/2025 më datën 13.10.2025

**Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.